

## KONTRATE SHITJE KUOTASH

Bazuar ne:

a- bazuar ne nenet 761 e vijues mbi dhurimin KC

b- N.47 i ligjit 7638 date 19.11.1992 mbi Shoqerite Tregtare

Sot me date 30.08.2002, ne Tirane, ndermjet ortakut te shoqerise KAZAZI shpk:

Islam Kazazi, biri i Idrizit, lindur ne Fllage, Durres, me 03.06.1967, banues ne Kavaje, Lagjia 5, Rruga Shaziman Harizi, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. UG 654550, ne cilesine e administratorit te shoqerise se "KAZAZI SHPK,

dhe

Shpetim Bizhdili, I biri I Banushit, lindur ne Kavaje, me 26.10.1963, banues ne Kavaje, Lagjia 5, rruga 1 Maji, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I pasaportes no. 0001052

Eshte rene dakort dhe perpilohet sa me poshte vijon:

Sipas vendimit n. 22328 date 02.11.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane, Islam Kazazi eshte ortak i vetem i shoqerise "KAZAZI" shpk ne keto raporte:

**OBJEKTI I KONTRATES:** Me ane te kesaj kontrate ortaku Islam Kazazi i shet Z. Shpetim Bizhdili 50 % te kuotave te poseduara prej tij ne kapitalin e shoqerise, i cili pranon te fitoje pronesine mbi keto kuota, kundrejt ketyre kushteve :

**CMIMI I KUOTAVE :** Kuotat – objekt kontrate kane nje cmim prej 50.000 (pesedhjetemije) lekesh dhe bleresi pranon ta levroje lirisht kete cmimi.

**GARANCITE:** Pala shitese e garanton palen blerese se kuotat – objekt kontrate jane te lira nga te gjitha debitet, pretendimet e te treteve mbi to, si dhe nga cdo barre pengu apo hipoteke.

**EFEKTET JURIDIKE:** Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe depozitimin e saj ne regjistrin tregtar te gjykates se rrethit Tirane, ortaku Isam Kazazi mbetet ortak me 50% te kuotave dhe Z.Shpetim Bizhdili, behet gjithashtu ortak me 50% te kuotave ne shoqerine KAZAZI SHPK.

**DITA EFEKTIVE E KONTRATES:** Kjo kontrate hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit te saj. Kontrata eshte e vlefshme ne rast se nenshkruhet para noterit.


Sa me lart, lexohet nga palet dhe nenshkruhet lirisht prej tyre:

### PALET KONTRAKTORE

SHITES

BLERES

ISLAM KAZAZI



SHPETIM BIZHDILI

